




Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina

KOMUNA E PRISHTINËS  
KRYETARI I KOMUNËS



Në bazë të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/04, qershor 2008), nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, të nenit 7 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Prishtinës 01-020/01-194101/18, dt. 08.08.2018, Kryetari i Komunës së Prishtinës merr këtë

V E N D I M

- I. MIRATOHET Vendimi për caktimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve në fushën e mirëqenies sociale, për rastet e varfërisë së skajshme të individit apo familjes, të fatkeqësive natyrore, të sëmundjeve të rënda kronike, të familjeve me përkujdesje të fëmijëve me çrregullime të përhershme shëndetësore, me fëmijë dhe personat e moshës madhore të cilët janë persona me aftësi të kufizuara si dhe për pagesë të qirasë.
- II. Komisioni i cekur në pikën I të këtij vendimi, është në këtë përbërje:
  1. Munavere Qerkezi, kryesuese, DMS
  2. Blerim Shabani, anëtar, QPS
  3. Shpend Rrustemi, anëtar, DSH
  4. Hetem Uka, anëtar, DF
  5. Sebahate Beqiri, anëtare, Shoqata "Down Syndrome Kosova".
- III. Detyrat e komisionit të cekur në pikën II të këtij vendimi, janë të cekura në nenin 7 dhe 8 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve nga komuna e Prishtinës 01-020/01-194101/18, dt. 08.08.2018 si dhe nenin 8 të Rregullores MF - nr. 04/2017, mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit të OJQ-ve.
- IV. Për kryerjen e këtyre detyrave të cekura në pikën III të këtij vendimi, komisioni i raporton Kryetarit të Komunës.

V. Shfuqizohen Vendimet me nr. 14-020/04-63196/21 i dt. 07.04.2021, Vendimi me nr. 15-020/04- 103738/21 i dt. 07.06.2021, Vendimi me nr. 14-020/04- 94246/21 i dt. 26.05.2021 dhe Vendimi nr. 14-020/04-103750/21 i dt. 07.06.2021.

VI. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

U dorëzohet:

- Drejtorisë për Mirëqenie sociale,
- Anëtarëve të Komisionit;
- Qendrës për shërbim me qytetarë,
- Në dosje.



KRYETARI I KOMUNËS  
Shpend Ahmeti